

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Lushnje, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

**PROCESVERBAL – Tipi i Kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje Materiale Elektrike për nevojat e Shoqërisë”

“Marrvëshje Kuadër me një Operator Ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuar, me afat  
12 muaj”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Pajisje  
Materiale Elektrike 31681410-0

- **VLERA E FONDIT LIMIT: 5 138 520** (pesë milion e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e pesëqind e njëzetë) Lekë Pa TVSH.

- 
- I. Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Autoriteti Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetlës Kanalizime Lushnje Sh.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8*

*b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 7 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

2.1.2. Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarise se Operatorit Ekonomik i njejte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera mesatare e se ciles, te jete jo me e vogel se 40% e vleres se llogaritur te Kontrates.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77 të LPP, si edhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pika 5 dhe 6, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ne vleren e marre reference per kufirin e raportit te % se kufirit te xhiros per te konsideruar te plotesuar kriterin e mesiperme, argumentojm se ky raport qe perben kufirin maksimal te percaktuar ne VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i atribuohet faktit se duke marre ne analize vleren e fondit limit eshte me se e mundur qe ky kufi iu jep mundesi te gjithë subjekteve ekonomik te cdo lloji kapaciteti financiar (te mesem dhe te vegjel), te kene mundesine e ofertimit pasi eshte marzhi tejet i aksesueshem

2.2.2. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitin financiarë 2021-2022-2023, të paraqitura dhe miratuara nga organet perkatese tatimore si dhe të shoqeruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e percaktimeve të Ligjit nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.*

2.2.3 Vërtetimi për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2023**, prane njesive vendore ku Operatori Ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës. **Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.**

**Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. Operatori Ekonomik fitues duhet të dorëzojë prane AK, përpara lidhjes së Kontrates, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 "Për QKB" i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "Për QKR" i ndryshuar. **PASI Mbështetur në faktin që në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST, ofertuesit vetëdeklarojnë, ndër të tjera që "Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së", ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.**

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (**2021-2022-2023**), në një vlerë jo më të vogël se **40 %** të vlerës së fondit të limitit të kësaj Kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të Kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të Kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët Ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar Kontratën.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë :

**2.3.2** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë çertifikate CE (kur është e aplikueshme) dhe/ose raporte testimi, për të gjithë mallrat objekt prokurimi.

**Argumentim:** Ky kriter është menduar për të dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e Specifikimeve Teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

### 2.3.3

Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë që merr përsipër transportin dhe levrimin e mallrave drejt ambjentëve magazinues të Autoritetit Kontraktor.

#### Argumentim

*Autoriteti Kontraktor në formulimin e kriterit për kapacitetin transportues të mallrave i qëndron rigorozisht faktit se Operatori Ekonomik i cili do të shpallet fitues duhet të kryejë edhe transportin në destinacion të mallrave objekt prokurimi për nevojat e Autoritetit Kontraktor i cili nuk do të paguaj shpenzime shtesë për këtë shërbim.*

### 2.3.4

a. Operatori Ekonomik, në momentin e hapjes së ofertave, duhet të paraqesë mostra për të gjitha zërat e kërkuara të cilat gjenden të listuar në Shtojcën 5 të DST. Mos dorëzimi i mostrave në momentin e hapjes së ofertave ose mospërputhja e mallrave të ofruara me mostrat e paraqitura, është kusht për skualifikim.

**Argumentim:** Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të vlerësojë mallrat objekt procedure prokurimi nëse janë në përputhje me Specifikimet Teknike dhe gjykon se prezantimi i mostrave ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Kriteri i kërkuar në lidhje me paraqitjen e mostrave, është vendosur në përputhje me piken 6/a, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

*e rregullave të prokurimit publik”. bazuar në Udhëzimin Nr. 2 datë 02.05.2019. Faza e paraqitjes së mostrave i shërben Autoritetit Kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen, me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga ana jonë. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje në pikën 6 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.*

### **Argumentimi i Specifikimeve Teknike**

*Specifikimet Teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. për ato pika të cilat përshihen në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit.**

**Operatori Ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së Kontrates, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.**

## **NJËSIA E PROKURIMIT**

**Serxhjo Zylali**

**Ferdinant Gjermani**

**Denisa Sina**